



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Nr. 90 Prot.

Fier, më 21.01. 2026

SHPALLJE Nr. 4

**E VENDEVE TË LIRA PËR PUNONJËS TË NJËSISË SË SHËRBIMIT
PSIKO-SOCIAL NË INSTITUCIONET PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
(IPAP) NË ZVAP NË VARËSI TË DRAP FIER**

Në zbatim të Ligjit nr.69 / 2012 “ Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njësive të shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, i ndryshuar, shpall vendet e lira të punës për punonjës në njësinë e shërbimit psiko-social (psikolog/punonjës-social) në institucionet publike të arsimit parauniversitar IPAP, në ZVAP-të në varësi të DRAP Fier.

I. Kriteret për t’u punësuar në shërbimin psiko-social

A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos ketë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative apo vërejtje në fuqi.

B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Kandidati duhet të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
2. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të dytë, në fushën përkatëse;
3. Njohuri bazë në kompjuter;
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata);
5. Aftësi komunikuese dhe punë në grup.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Përshkrimi i edukimit dhe i karrierës profesionale- jetëshkrimin (Curriculum vitae), sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
2. Kërkesë për punësim në zyrën arsimore që dëshiron për pozicionin psikolog / punonjës social (e detyrueshme);
3. Raport mjeko-ligjor i tri muajve të fundit (i detyrueshëm);

4. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
5. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
6. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka);
7. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës/diplomave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë, cikli i dytë dhe diplomat e integruara të ciklit të dytë) ose të barazvlefshme me këto sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit (e detyrueshme);
8. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master (e detyrueshme);
9. Leje për ushtrimin individual të profesionit (licencë);
10. Kopje e njehsuar me origjinalin e arsimit shtesë dhe listës së notave si dhe certifikatave për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale (e detyrueshme);
12. Dëshmi penaliteti (e detyrueshme); -
13. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetëdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar (e detyrueshme).

14. Kualifikimi dhe vlerësimi i kandidatëve do të bazohet edhe në kreun VII, pika 4 të Urdhërit nr. 313 datë 20.10.2020, të ndryshuar.

B. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Fier brenda afatit 21.01.2026- 25.01.2026.

- III. Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve për psikolog /punonjës social do të kryhet nga komisioni në datën 26.01.2026.
- IV. Rezultatet paraprake të vlerësimit të dokumentacionit do të shpallen në faqen zyrtare të DRAP Fier në datë 27.01.2026.
- V. Ankimimet brenda datës 29.01.2026.
- VI. Rezultatet përfundimtare do të shpallen në datën 29.01.2026.
- VII. Bazuar në renditjen përfundimtare, DRAP Fier do të ndjekë procedurat e emërimit sipas përcaktimeve të Urdhërit nr.313/2020 i ndryshuar.
- VIII. Vendet e lira sipas ZVAP-ve përkatëse bashkëlidhur.

DREJTORI

Zaira Gjika



LISTA E VENDEVE TË LIRA PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT PËR SHPS

21.01.2026

Nr	Drap	Zvap	Shkolla	Psikolog/P/Sc	Kontrata me afat/ pa afat
1	Fier	Fier	100 Vjetori i Pavarësisë	Psikolog	Me afat
2	Fier	Fier	Xhevit Fetahu	P.Social	Me afat
3	Fier	Fier	5 Deshmoret	P.Social	Me afat
4	Fier	Fier	Mustafa Hoxha	P.social	Me afat
5	Fier	Fier	Ymer Xhafa	P.Social	Me afat
6	Fier	Patos	Gjimnazi Zhani Ciko	Psikolog	Me afat
7	Fier	Roskovec	Jashar Muhameti	P.Social	Me afat
8	Fier	Mallakaster	Besëlidhja	P.Social	Me afat
9	Fier	Mallakaster	Gjokë Doçi	P.Social	Me afat
10	Fier	Lushnje	4 Deshmoret	P.Social	Me afat
11	Fier	Divjakë	Çermë e Sipërme	Psikolog	Me afat
12	Fier	Vlorë-Himarë	24 Maji	Psikolog	Me afat
13	Fier	Vlorë-Himarë	P.N.Meniko	Psikolog	Me afat
14	Fier	Vlorë-Himarë	Pilo Prifti	Psikolog	Me afat
15	Fier	Selenicë	Qani Nuredini	Psikolog	Me afat
16	Fier	Tepelene-Memaliaj	7-Marsi	Psikolog	Me afat
17	Fier	Tepelene-Memaliaj	Nimete Progonati	P.Social	Me afat
18	Fier	Tepelene-Memaliaj	Adem Alushi	P.Social	Me afat
19	Fier	Permet-Kelcyre	Sejfulla Maleshova	Psikolog	Me afat
20	Fier	Permet-Kelcyre	Lumo Pavari	P.Social	Me afat
21	Fier	Gjirokaster-Libohove	Asim Zeneli	Psikolog	Me afat
22	Fier	Gjirokaster-Libohove	Avni Rustemi	P.Social	Me afat
23	Fier	Gjirokaster-Libohove	Pandeli Sotiri	P.Social	Me afat
24	Fier	Sarandë-Konispol-Delvinë	Hasan Tahsini	Psikolog	Me afat
25	Fier	Sarandë-Konispol-Delvinë	Mehmet Xhaferi	P.Social	Me afat
26	Fier	Finiq-Dropull	SHB Dervican	Psikolog	Me afat